

Më
Dana

12 - 12 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi, me procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale nga neni 188 par. 2 dhe par. 1 nënëar. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.2052-4/2013 të datës 02.05.2014, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datën 11.05.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datën 20.05.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], nga fsh. [REDACTED], rr. " [REDACTED] "Komuna Ferizaj, me profesion Zjarrfikës, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] nga Shtimja rr. " [REDACTED] " nr [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, i martuar babë i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari [REDACTED]

ËSHITË FAJTOR

Se me datën 17.09.2013, në fsh. Carralevë afër pompës së benzinës “Sharri ” papritmas në rrugën “Komandat Kumanova” në Shtime, i pandehuri [REDACTED] kishte tejkaluar me veturën e tij [REDACTED], ku i kishte bllokuar rrugën dhe po sa kishte zbritur nga vetura e kishte goditur me një shufër metalike në gjoks, ku nga pasojat e këtyre goditjeve i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje (mbretje) e indeve të buta të kafazit të krahavorit, në regjionin e shpatullës së majtë, e të cilat lëndime rezultojnë me dëmtim të përkohshme të shëndetit.

me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.

1 nënpar. 1.4 të KPRK -së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 188 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 dhe 74 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, e

GJYKON

- Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 Euro /dyqind/, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.
- I dëmtuari [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Suharek, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 / njëzetë / €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20 /njëzetë/ €, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së

REFUZOHET AKUZA

I akuzuari [REDAKTUAR]

Se me datën 17.09.2013, në fsh. Carralevë afër pompës së benzinës “ Sharri ” papritmas në rrugën “ Komandat Kumanova ” në Shtime, i pandehuri [REDAKTUAR] kishte tejkaluar me veturën e tij [REDAKTUAR] ku i kishte bllokuar rrugën dhe po sa kishte zbritur nga vetura e kishte goditur me një shufër metalike në gjokes, e më pas edhe i pandehuri [REDAKTUAR] e kishte sulmuar me duar dhe e kishte kapur për gjoksi të dëmtuarin, ku nga pasojat e këtyre goditjeve i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje (mbretje) e indeve të buta të kafazit të kraharorit, në regjionin e shpatullës së majtë, e të cilat lëndime rezultojnë me dëmtim të përkohshme të shëndetit.

me këtë do të kryente veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK -së.

Meqë Prokurori i Shtetit gjatë shqyrtimi gjyqësor është tërhequr nga akuza meqë nuk vërtetohet me asnjë veprim inkriminues se ka kryer veprën penale për ç'ka akuzohet.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Suharek, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet sa i përket pjesës II të këtij aktgjykimi bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar ndaj të pandehurve gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.2052-4/2013 të datës 02.05.2014, ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] nga Komuna Suharek dhe [REDAKTUAR] nga Komuna e Shtimes, për veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehet trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datën 11.05.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar fajtor për veprën për të cilën me ngarkon akuza sipas të gjitha pikave të saj, si dhe në mendimin e tij mbi pranim shton se me vjen keq për këtë veprë penale, ndihem thelle i penduar, i kërkoj falje publike të dëmtuarit dhe gjykatës, duke premtuar që në të ardhmen nuk do të ndodhë një veprim i tillë, me që me të dëmtuarin janë nip e dajë dhe se jemi pajtuar dhe kemi raporte të mira, kërkoj nga gjykata ti këtë parasysh këto rrethana se kam*

gabuar, lus gjykatën qe ti ketë parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

- si dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: ekspertiza e mjekut ligjor e datës 25.03.2015, raporti i oficerit 2013-AU-0330 i datës 17.09.2013, raporti mjekësor Q.K.M.F në Therandë me numër të protokollit 20438 i datës 17.09.2013, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e datës 17.09.201, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e datës 17.09.2013, si dhe shkresat e lëndës të cilat gjenden ne lëndë, të gjitha këto veprime te mbledhura ne hetuesi.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Në këto rrethana të ndodhura përpara faktit të parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave të marra në gjykim të kësaj çështje, gjykata çmon se me veprimin e të pandehurit janë prezent elementet e kundërligjshëm të veprës penale të sipërcekur, i pandehurit me këto veprime i shkaktuar të dëmtuarit [REDAKTUAR] dëmtim të përkohshme të shëndetit i pandehurit ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1. 4 të KPRK-së.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale 188 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivit të këtij aktgjykimi i akuzuari me dashje direkte e ka goditur të dëmtuarin me një shufër metalike në gjokes, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoj të përkohshme për shëndetin të përshkruar në ekspertizën mjeko-ligjore të datës. 25.03.2014.

Nga ana objektive, kjo veprë është kryer nga i pandehuri [REDAKTUAR] me veprime aktive të kundërligjshme, fillimisht me përdorimin e forcës dhe me mjet të përshtatshëm shufër metalike.

Nga ana subjektive këto veprime janë kryer nga të pandehurit [REDAKTUAR] dhe me dashje direkte kishte tejkaluar me veturën e tij [REDAKTUAR] ku i kishte bllokuar rrugën dhe po sa kishte zbritur nga vetura e kishte goditur me një shufër metalike në gjokes, pasi që i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre, por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, ç'ka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprave penale.

Analizuar nga rrethanat e kronologjisë së rastit dhe provave materiale të cilat janë në shkresat e lëndes si dhe vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 dhe të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese, përkatësisht që në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e thellë dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, premtimin se në të

ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, gjendjen ekonomike të dobët, ndërsa në rastin konkret si rrethana rënduese vlerësoj mënyrën e vrazhdë të kryerjes së veprës penale si dhe vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se te akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale kane bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe me autoret të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Suharek, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 / njëzetë / €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20 /njëzetë/ €, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II

Sa i përket pjesës së dytë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues, Prokurori i Shtetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se bazuar nga deklarat e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhënë me dt. 17.09.2013, vërtetohet çart se nuk ka marrë asnjë veprim inkriminues në realizim të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj, në bazë të nenit 52 të KPRK-së, kundër të pandehurit [REDAKTUAR], heqi dorë nga ndjekja penale.

Pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza kundër të pandehurit gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika.1 .1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të II të këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-së, shpenzime sa i përket pjesës nën II të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Suharek, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -

P.nr.507/14, më dt. 20.05.2018

**Bashkëpunëtori Profesional,
Faredin Ilazi**

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.